Lezhë, më 06.07.2022

# PROCESVERBAL

I mbajtur sot, në dt. 06.07.2022, në orën 12:00, në sallën e Qendrës Kulturore të Fëmijëve (QKF), mbi mbledhjen jashtë radhe, të kërkuar nga Kryetari i Bashkisë, pasi për shkak të procesit të rindërtimit, aktet e paraqitura nuk presin dot mbledhjen e radhës të këshillit Bashkiak.

Mbledhja u hap nga Kryetari i K.B. Lezhë, z. Ernest Rokaj, i cili deklaroi praninë e kuorumit dhe lexoi rendin e ditës të njoftuar më parë.

z. Rokaj hodhi në votim rendin e ditës që u miratua nga të gjithë këshilltarët prezentë.

z. Agostin Marku propozoi që katër p/vendimet që kanë të bëjnë me tërmetin, të kalohen në votim pa diskutim, ndërsa pika 5 është tjetër gjë.

Ernest Rokaj: Atëherë kalojmë në votim pikën e parë të rendit të ditës që është projekt-vendim "Për miratimin e listave të subjekteve ankues të cilëve iu pranua ankesa nga Komisioni i Ankimit për kategorinë DS4, DS5 të cilat kanë analizë të thelluar nga Instituti i Ndërtimit"

Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.

Kalojmë në votim pikën e dytë të rendit të ditës, që është projekt-vendim "Për miratimin e listës së subjekteve ankues për kategorinë DS1, DS2 dhe DS3, të cilëve iu është pranuar ankesa nga Komisioni i Ankimit".

Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.

kalojmë në votim pikën e tretë të rendit të ditës, që është projekt-vendim "Për miratimin e listës së subjekteve përfituese për grante rindërtimi për banesa në ndërtese (pallat) me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5 sipas analizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit, në Bashkinë Lezhë dhe strukturës së banimit përkatëse".
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
Kalojmë në votim pikën e katërt të rendit të ditës, që është projekt-vendim "Për përcaktimin e strukturës së banimit për subjektet përfituese në ndërtesat (pallatet) të rindërtuara pas tërmetit të 26 nëntorit në lagjen "Besëlidhja"".
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
Atëherë kalojmë te pika e pestë e rendit të ditës që është projekt-vendim "Për një shtesë e ndryshim në Buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2022 dhe përdorim të fondit të emergjencës për "Rehabilitimin e murit mbajtës në rrugën e Spitalit Rajonal Lezhë"".

- Kryetari i dha fjalën Zv/Kryetarit të Bashkisë z. Ermal Pacaj për të dhënë shpjegimet përkatëse lidhur me këtë p/vendim.

Ermal Pacaj: Është një fond i ardhur nga Emergjencat Civile, i cili duhet përdorur, sepse ka një afat. Bëhet fjalë për një rrëshqitje dheu që kemi pasë te lagjja e Spitalit, ngjitur me

kopshtin privat të Joshar Shehut. Aty kemi bërë një projekt të hollësishëm sepse një ështe pjesë për rrezikon. E kemi sjellë në këshill për të bërë ndryshimin në buxhet

- Pati diskutime për procedurë, por jo në lidhje me përmbajtjen e projekt-vendimit.
- Ernest Rakaj: E kalojmë projekt-vendimin në votim.

Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.

Ju falenderoj

Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

| SEKRETARI | KRYETARI |
| --- | --- |
| FLORIDA ÇUNAJ | Ernest Rakaj |